



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr.____ Prot.

Datë : 17/ 02 / 2009

VENDIM

Nr.102 datë 17/02/ 2009

Për

Rekomandime ndaj Projekt –Ligjit “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17 /02 /2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vlerësimi i Projekt-Ligjit “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”

Baza ligjore:

- Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, gërma “f” dhe neni 69, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Shkresës Nr. 35/1 Prot datë 03. 02. 2009 të Institutit Kombëtar të Auditëve

VËREN SE:

Me anë të shkresës Nr. 35/1 datë 03. 02. 2009 Instituti Kombëtar i Auditëve i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës, vlerësimin e tij për projekt –ligjin “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Në bazë të nenit 69 të Ligjit 9121, datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës, jep vlerësime për projekt-aktet normative në lidhje me shkallën e

kufizimit ose të pengimit të konkurrencës si dhe me kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin, vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta në zona të caktuara për ndërmarrje ose produkte të caktuara dhe imponimin e praktikave të njëjta me çmimet dhe kushtet e shitjes.

Duke u bazuar në praktikat e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD – së, profesionet e lira, të tilla si avokatët, juristët, kontabilistët, farmacistët, mjekët, etj., janë subjekt i rregullimeve të veçanta, të tilla si kufizimet e reklamave, nivelet e komisioneve, të drejtave ekskluzive dhe rregullave për të ndaluar bashkëpunimin ndër-profesional, për shkak të sigurimit të një shërbimi profesional dhe cilësor.

Komisioni i Konkurrencës është i mendimit se, me anë të këtij projekt ligji, synohet rregullimi i funksionimit të shërbimeve të profesionit të ekspertit kontabël të autorizuar dhe profesionit të kontabilistit të miratuar nëpërmjet rritjes së mbikëqyrjes publike mbi këto profesione.

Pas shqyrtimit të Projekt–Ligjit “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, sipas mendimit të Komisionit të Konkurrencës, nuk konstatohet ndonjë dispozitë që bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24 germa “f” dhe nenit 69, pika 2, të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit;

VENDOSI:

- Projekt – Ligji “Për auditimin ligjor të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar” nuk përmban shkallë të kufizimit apo pengimit të konkurrencës në lidhje me ushtrimin e profesioneve të lira, në kuptim të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”;
- Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm t’ia komunikojë këtë vendim Ministrisë së Financave dhe palëve të tjera të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCES

Lush PERPALI

Servete GRUDA

Koço BROKA

(_____)

(_____)

(_____)

Zv/Kryetar

Anëtare

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

KRYETARE